



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1384\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_2202\_06\_21**;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 02.08.2021;

në seancën e mbajtur më datë 02.09.2021 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F.P nga Komuna e Podujevës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2202\_06\_21, i datës 30.06.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 30.06.2021 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2202\_06\_21 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit F.P lidhur me kontestimin e faturave për shkak të dyshimit të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 47443740.

I pakënaqur me vendimin e DMK-së, konsumatori F.P. brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Shkeljes esenciale të dispozitave ligjore;
- Konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vlerësimit të shpenzimit të energjisë elektrike.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave ligjore, Bordi thekson se, janë analizuar me kujdes provat e administruara nga DMK, si shkallë e parë në ZRrE, si në vijim: Rrjedhën e Energjisë Elektrike, Procesverbalin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org.02, nr.1738 i dt. 01.02.2016, ankesën e konsumatorit të dt.29.12.2016, Përgjigjen e KESCO-s të dt.28.03.2019, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të dt. 28.03.2018, Vendimin e DMK-së me



nr. V\_2202\_06\_21 dhe ka konstatuar se vendimi i shkallës së parë është vendim i ligjshëm dhe i bazuar në provat materiale si në shkresat e lëndës.

Sipas Rrjedhës së Energjisë Elektrike dhe listave të leximit, Bordi ka vërtetuar se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektime dhe lexime të rregullta mujore, dhe në asnjë periudhë nuk është evidentuar që nuk ka qasje në leximin e njehsorit elektrik apo që dyshon se njehsori elektrik nuk bën matje jo të saktë. Nga analiza e bërë shpenzimeve të energjisë, me dy njehsorët elektrikë, njehsorin kontestues nr.47443740 për periudhën 01/2014 deri në periudhën 04/2015 si dhe njehsorin nr.16077111 nga periudha 05/2015 e tutje, Bordi thekson se konsumatori ka ndryshim në shpenzimet mujore, por që kjo nuk është si rrjedhojë e mos matjes së sakte të njehsorit nr.47443740 pasi që konsumatori edhe pas ndërrimit të njehsorit nr.47443740 për periudhë shtatëmbëdhjetë mujore (05/2015 - 09/2016 shpenzimi mesatar ka qenë 944 kWh/muaj) ka vazhduar të ketë shpenzim të lartë me njehsorin e ri nr.16077111. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve mujore me njehsorin nr.47443740 për periudhën 01/2014 deri në periudhën 04/2015 është **1,109 kWh/muaj** (periudhë 16 mujore), kurse me njehsorin e ri nr.16077111 për periudhën 05/2015 deri në periudhën 08/2016 është **958.38 kWh** (periudhë 16 mujore). Gjithashtu DMK ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të dy njehsorëve për periudha të njëjta kohore, dhe kemi vërejtur se mesatarja e shpenzimeve mujore me njehsorin nr.47443740 për periudhën 05/2014 deri në periudhën 04/2015 është **1,091 kWh/muaj** (periudhë 12 mujore), kurse me njehsorin e ri nr.16077111 për periudhën 05/2015 deri në periudhën 04/2016 është **939 kWh** (periudhë 12 mujore). Pra shihet qartë se në periudha të njëjta kohore nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike për periudha të njëjta kohore. Ndërsa sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve mujore me njehsorin nr.47443740 për periudhën 01/2014 deri në periudhën 04/2015 është **1,109 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri nr. 16077111 për periudhën 05/2015 deri në periudhën 06/2021 është **534 kWh**. Bazuar në të gjeturat vërtetohet se konsumatori ka rënie të shpenzimit të energjisë me njehsorin e ri nr.16077111 nga periudha tetor 2016 e tutje.

Bordi po ashtu ka analizuar edhe Procesverbalin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org.02, nr.1738 të dt.01.02.2016, në të cilin nga Qendra e Kalibrimit është konstatuar se njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik i ka bllokat shtetërore, nga ana e jashtme njehsori elektrik nuk ka dëmtime, kurse gabimi në matje është +0.33%. Duke iu referuar nenit 4.11 të Kodi të Matjes të OSSh-së, Bordi thekson se gabimi në matje është brenda kufirit të lejuar në matje e që është +-2.5%.

Andaj, nga sa u tha më sipër, vërtetohet se nuk kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave ligjore, e as konstatim të gabuar të gjendjes faktike, sepse, duke u bazuar në faktet si në vijim:

- Se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt;
- Se pas krahasimit të shpenzimeve është konstatuar se konsumatori nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike në periudha të njëjta kohore dhe
- Se duke u bazuar në Procesverbalin e Qendrës së Kalibrimit, ka rezultuar se njehsori është në rregull dhe gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar të matjes.

Kësisoj, Bordi thekson se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, duke u bazuar në provat materiale si në shkresat e lëndës.



Bordi i ZRrE-së bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar të zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRrE-ja dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara), ashtu sic është rënë dakord në kontratën për furnizim”.*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar argumente të qëndrueshme dhe prova tjera.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit F.P. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar